


Inovacioni në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

Vitet 2016-2018

Tiranë, më 17 Tetor 2019: INSTAT me vendet e tjera të rajonit kryen vrojtimin mbi “Inovacioni në ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme”. Sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike (NVE), vrojtimi mbulon aktivitetet e Prodhimit të produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë, Telekomunikacionit, Shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe Aktivitetet e shërbimit të informacionit (për më shumë info shih fq.4, Metodologjia).

Sipas të dhënave të mbledhura, gjatë periudhës trevjeçare, 2016-2018, 46,9 % e ndërmarrjeve rezultuan inovative. Ndërmarrjet që ofrojnë Shërbime të teknologjisë së informacionit (NVE 62), ku përfshihen Aktivitete të programimit informatik, Aktivitete të këshillimeve informatike, Aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike, Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit, janë inovatorët më aktivë me 53,2 %.

Fig. 1: Ndërmarrjet aktive në Inovacion, 2016 – 2018




Burimi: Instituti i Statistikave, INSTAT

Aktiviteti i inovacionit të ndërmarrjeve rezulton në përpjestim të zhdrejtë me madhësinë e tyre. Përqindja e ndërmarrjeve me **0 deri 9 punonjës të angazhuar në aktivitetin e inovacionit ishte 95,6 %**, për ndërmarrjet me 10 deri 49 të punësuar kjo përqindje ishte 4,0 % dhe ndërmarrjet me 50-249 të punësuar ishte 0,4 %.

Për periudhën trevjeçare, 2016-2018, 42,8 % e ndërmarrjeve rezultojnë inovatore të produkteve ose proceseve, ndërsa 1,9 % e tyre ishin ndërmarrje që nuk kishin zhvilluar inovacion por kishin ndërmarrë aktivitete inovacioni të braktisura ose pezulluara ose ende në vazhdim gjatë vitit 2018.

Fig. 2: Llojet e aktiviteteve të Inovacionit të zhvilluara nga ndërmarrjet, 2016 – 2018




Burimi: Instituti i Statistikave, INSTAT

Mesatarisht 8,7 % e ndërmarrjeve të intervistuar që kryenin aktivitete inovative në periudhën 2016-2018 **ishin pjesë e grupeve të ndërmarrjeve** dhe 40,3 % e tyre kishin selinë qendrore jashtë vendit. Për sa i përket shitjeve sipas tregjeve gjeografikë, 87,7 % e ndërmarrjeve inovative shesin produktet e tyre (mallra dhe shërbime) në tregun kombëtar, ndërsa 18,6 % e shitjeve ishte në tregun rajonal (Ballkan-Mesdhe) - Bullgari, Qipro, Maqedonia e Veriut dhe Greqi. Në të njëjtën kohë, 20,9 % e ndërmarrjeve i shesin prodhimet e tyre në tregjet e vendeve të tjera të Bashkimit Evropian dhe EFTA (Islandë, Norvegji, Principata e Lihtenshtajnit, Zvicër), ndërsa 7,1 % në tregjet e shteteve të tjera.

Bashkëpunimi në inovacion rezulton të jetë modest, ku **shumica e ndërmarrjeve nuk bashkëpunojnë** me ndërmarrje të tjera, institucione dhe universitete për realizimin e aktiviteteve të inovacionit. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se vetëm 19,9 % e ndërmarrjeve inovative kanë bashkëpunuar në vitet 2016-2018. Bashkëpunimi me institucione qeveritare ose publike kërkimore-shkencore, universitete ose institucione të arsimit të lartë dhe klientë ose konsumatorë nga sektori publik u vlerësuan si bashkëpunimet më të shpeshta, ndërsa përsa i përket partnerëve bashkëpunues në vend të parë qëndrojnë bashkëpunimet me partnerët kombëtare me 89,4 %.

Nga vrojtimi rezulton se 5,9 % e ndërmarrjeve të cilat raportojnë që kanë zhvilluar aktivitete inovacioni **kanë marrë fonde publike** gjatë periudhës 2016-2018. Institucioni më i zakonshëm i financimit ishte Bashkimi European me 84,7 %, ndërsa 71,3 % e ndërmarrjeve me aktivitete të inovacioni morën fonde nga Qeveria qendrore (duke përfshirë agjencitë e qeverisë qendrore ose ministritë).

Fig. 3: Burimet financiare publike për Aktivitetin e Inovacionit, 2016 – 2018



Burimi: Instituti i Statistikave, INSTAT

Faktorët që pengojnë në zhvillimin e inovacionit në ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme janë kostot e larta dhe konkurrenca. Në 73,5 % të ndërmarrjeve, faktori më i rëndësishëm në pengimin e inovacionit janë **kostot tepër të larta të inovacionit**. Pengesë tjetër financiare, raportuar nga ndërmarrjet, është konkurrenca e lartë në treg me 72,9 %.

Metodologjia

Në kuadër të projektit “Ngritja e Kapaciteteve të Inovacionit të ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Programi i Bashkëpunimit Ndër-kombëtar Interreg V-B (Ballkan-Mesdhe 2014-2020)”, me financim nga Bashkim Europian dhe Qeveria Shqipëtare u zhvillua nga INSTAT vrojtimi mbi Aktivitetin e Inovacionit në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.

Qëllimi i projektit të Inovacionit në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme është të rrisë kapacitetin transnacional të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe ti mbështesë ato në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm, duke përfshirë grupe inovative me NVM të tjera nga rajoni për të ndarë njohuritë dhe zhvillimin e inovacioneve.

Objekt i këtij vrojtimi janë ndërmarrjet që kanë kryer aktivitet ekonomik gjatë tre viteve, për të cilin kryhet vrojtimi, vitet paraardhëse të vitit aktual kalendarik (në vitin 2018 merret informacion për aktivitetin inovativ ose jo, të kryer gjatë viteve 2016, 2017, 2018).

Vrojtimi i kërkuar nga INSTAT ka përfshirë ndërmarrjet private sipas aktiviteteve të NVE Rev. 2 përkatësisht në ndarjet: NVE 26 – Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë, NVE 61 – Telekomunikacioni, NVE 62 – Shërbime të teknologjisë së informacionit, NVE 63 – Aktivitete të shërbimit të informacionit, me numër të punësuarish nga 0 deri në 249, pavarësisht formës ligjore dhe të shpërndara në gjithë territorin shqiptar.

Mbledhja e informacionit është kryer me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit në ndërmarrjet e paracaktuara për intervistim. Faza e terrenit është zhvilluar në Dhjetor 2018 dhe ka zgjatur 2 javë.

Përkufizime

Inovacioni është implementimi nga një ndërmarrje i një malli, produkti, procesi, metode organizimi apo marketingu, të ri apo të përmirësuar dukshëm. Një inovacion duhet të jetë i ri për ndërmarrjen, edhe pse mund të jetë zbatuar tashmë nga ndërmarrje të tjera.

Inovacioni në produkt është implementimi i një produkti, malli apo shërbimi që është i ri ose i përmirësuar dukshëm në lidhje me karakteristikat apo përdorimin e pritur të saj/tij. Kjo përfshin përmirësime të dukshme në specifikimet teknike, komponentët dhe materialet, software-in e inkorporuar apo karakteristika të tjera funksionale.

Inovacioni në proces është implementimi i një metode prodhimi ose shpërndarjeje të re apo të përmirësuar dukshëm. Kjo përfshin ndryshimet e dukshme në teknika, pajisje dhe/ose software.

Inovacioni organizativ është zbatimi i një metode të re organizative në praktikat e një ndërmarrjeje, në mënyrën e organizimit të vendit të punës ose marrëdhënieve të jashtme.

Inovacion marketingu është zbatimi i një metode të re marketingu ose kryerja e ndryshimeve domethënëse në dizenjimin e produktit apo ambalazhimin e tij (duke përjashtuar ato ndryshime që vijnë si pasojë e ndryshimeve rutinë/sezonale), vendosjen e produktit, promovimin apo çmimin e këtij të fundit.

Aktiviteti i inovacionit përfshin të gjitha aktivitetet zhvillimore, financiare dhe tregtare, të ndërmarra nga një ndërmarrje, të cilat synojnë ose rezultojnë në një inovacion.